



AGJENCIA E MBIKËQYRJES POLICORE

PRILL 2024

VEPRIME HETIMORE

Gjatë muajit Prill janë kryer **20** referime në Prokurori për **38** punonjës të Policisë së Shtetit, **1** punonjës të Gardës së Republikës, si dhe **4** shtetas, të dyshuar për vepra të ndryshme penale.

ARRESTUAR NË FLAGRANCË

3 persona (**1** punonjës policie, **1** efektiv i Gardës së Republikës dhe **1** shtetas)

EKZEKUTIM I VENDIMEVE PROKURORI/GJYKATË

3 masa ndaluese “Arrest me burg”, nga të cilët; **1** punonjës policie dhe **2** shtetas

“Pezullim i ushtrimit të një detyre a shërbimi publik” për **2** oficerë policie

4 INSPEKTIVE TË KRYERA

Gjatë muajit Prill janë kryer në total **4** inspektive të strukturave që janë objekt i veprimtarisë së AMP, nga të cilat **1** i planifikuar dhe **3** të paplanifikuar.

KOMISIONI DISIPLINOR

-Për **3** punonjës policie, Komisioni ka vendosur: “Përfundimin e hetimit disiplinor” pa shkelje administrative.

-Për **1** punonjës policie, Komisioni ka vendosur: “Përfundimin e hetimit” për Shkelje të Rëndë dhe rekomandimin për fillim hetimi disiplinor për Shkelje të Lehtë nga DVP Tiranë.

-Për **2** punonjës policie, Komisioni ka vendosur: “Mosfillimin e hetimit disiplinor”, pasi po hetohet për të njëjtën shkelje nga Drejtoria e Standardeve Profesionale në DPPSH.

-Për **5** punonjës policie, Komisioni ka vendosur: “Mosfillimin e hetimit disiplinor” pasi u konstatua se shkelja disiplinore është parashkruar.

-Për **3** punonjës policie, Komisioni ka vendosur: “Mosfillimin e hetimit disiplinor”, pasi nuk konstatohet shkelje.

ANKESAT



128 ANKESA TË TRAJTUARA

14 raste, ankesat të drejta
87 raste, ankesat të pabazuara
27 raste, ankesat nuk provohen



153 ANKESA TË ADMINISTRUARA



278 TELEFONATA

146 brenda AMP
42 jashtë AMP
90 dhënë informacioni

DENONCO

08009090

ankesa@amp.gov.al